



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:274696

Datë: 16.05.2022

Numri i dokumentit: 03026253

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.10/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, (në objektin e gjykatës në Mitrovicë, Veri), Kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët Gëzim Ademi dhe Rrahman Beqiri, procesmbajtësi Endrit Hajrizaj, në çështjen penale kundër të pandehurit E.F, i akuzuar për veprat penale; I. Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), II. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, III. Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.3873/2019 dt.20.12.2019. Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë në prezencën e palëve, Prokurorit të Shtetit në PTH në Mitrovicë, Naim Beka dhe i pandehuri E.F, mbrojtësi i tij, av.Ahmet Tahiri, në mungesë të dëmtuarve, Gjykata më datën 02.03.2022, ka shpallur publikisht aktgjykimin, ndërsa më dt.16.05.2022 është përpiluar me shkrim ky;

A K T G J Y K I M

I pandehuri;

E.F nga i ati T.... e ëma Xh...., e gjinisë K....., i lindur me dt..... në V....., ku edhe jeton në Rr.....- V....., me numër personal të identifikimit: ....., ka të përfunduar shkollën fillore 8 vjeçare, me profesion shofer, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ndaj tij zhvillohen edhe disa procedura tjera penale, i njëjti;

I.

Në mbështetje të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Kodit të procedurës Penale të Kosovës;

LIROHET NGA AKUZA

SEPSE:

Më datën 23.11.2019, rreth orës 09:40, në rrugën magjistrale V.....-P....., konkretisht përballë

lokalit “.....” në V..... i pandehuri, me armën e tij revole me kalibër 6.35mm, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve konkretisht të dëmtuarve: H.M, B.N, I.I, SH.F, A.M, dhe N.M, ashtu që i pandehuri ditën kritike pas një mosmarrëveshje që kishte me të dëmtuarit Sh.F dhe A.M, meqenëse i njëjti me veturën e tij të tipit Passat ngjyrë e gjelbër me targa 00-000-00 më herët kishte hyrë brenda shiritit i cili ishte vënë nga Kompania “S.....” për të cilën punonin të dëmtuarit, e në momentin kur nga ana e të dëmtuarve i ishte kërkuar të pandehurit që ta largonte veturën, i njëjti kishte filluar t’i ofendojë e për një moment në bashkëbisedim e sipër i pandehuri e kishte nxjerrë nga xhepi i djathtë armën e lartcekur dhe kishte shtie në drejtim të dëmtuarve dy herë, kurse më pastaj i pandehuri fillon të vrapojë përsëri në drejtim të të dëmtuarve e kur arrijnë në afërsi të një kamioni ka shtënë edhe dy herë ku njeri nga predhat e ka goditur gomën e kamionit, e me pastaj i pandehuri është ndaluar nga disa qytetar rasti të cilin e kanë larguar nga vendi ngjarjes.

- Më këtë kishte për të kryer veprën penale; Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 e sanksionuar sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

## II.

### SHPALLET FAJTOR

#### SEPSE:

Në ditën, kohën dhe vendin si në pikën e I-të të dispozitivit, i pandehuri, me dashje dhe me qëllim të kërcënimit dhe frikësimit, ka përdorur armën e llojit pistoletë “Ekol Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ....., e prodhuar në Turqi, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët Ligjin Nr.05/L -022. Ashtu që ditën kritike nga gjepi i palltos e kishte nxjerrë armën e lartcekur dhe me qëllim kërcënimit dhe frikësimit të të dëmtuarve ka shtënë dy herë me këtë armë, një herë në drejtim lartë apo në ajër dhe herën tjetër me drejtim poshtë në tokë ku predha e ka goditur gomën e kamionit që ka qenë aty afër. Pastaj disa qytetarë të rasti e kanë vënë nën kontroll të pandehurin dhe e kanë larguar nga vendi ngjarjes.

- Me këtë ka kryer veprën penale; Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 e sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

### III.

#### SHPALLET FAJTOR

##### SEPSE:

Në ditën kritike, kohën dhe vendin si në pikën I- të aktakuzës, i pandehuri ka poseduar armën e llojit pistoletë “Ekol Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ....., e prodhuar në Turqi, në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm për armë, Ligjin Nr.05/L -022, të cilën armë i pandehuri pa leje e ka mbajtur në kontroll dhe posedim deri më dt.23.11.2019, ditën kur policia e Kosovës, e sekuestron këtë armë nga i pandehuri.

- Me këtë ka kryer veprën penale; Mbajtja në pronësi në kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 e sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 40, 42, 43, 69, 70, 71,72, të KPRK-ës, e lidhur me nenet 365 dhe 366 të KPP-së, të pandehurit, i;

#### S H Q I P T O N

Për veprën penale si në pikën II;

- DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.23.11.2019 e deri më datën 03.04.2020 si dhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga dt.03.04.2020 e deri më datën 03.05.2020, DHE
- DËNIM ME GJOBË në shumën prej 500 (pesëqind) euro

Për veprën penale si në pikën III:

DËNIM ME GJOBË në shumën prej 500 (pesëqind) euro

Në mbështetje të nenit 76 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të KPRK-ës, shqipton;

- DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro, të cilin dënim-gjobë obligohet ta paguaj brenda afatit prej tre (3) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se nuk e paguan këtë gjobë, atëherë gjoba do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i’u përlllogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20€ (njëzet euro) dënim me gjobë.

- OBLIGOHET i pandehuri E.F që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 euro, shpenzimet për ekspertizën psikiatrike në shumë prej 408.80€, për pjesëmarrjen e eksperti seancë shumë prej 50 euro, për taksë në Fondin për kompensimin e viktimave të krimit, shumë prej 50 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Marrjen e sendeve;

Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 e 2 të KPP-së, dhe nenit 366 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndaj të pandehurit lëshon këtë:

URDHËR - URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve si në vijim:

Arma e llojit pistoletë “Ekol Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ....., e prodhuar në Turqi, dy gëzhoja, karikator i armës dhe dy fishek.

- I. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, arma duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, pasi që të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.
- II. Palët e dëmtuara për realizimin kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

#### A r s y e t i m

- Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.3873/19 dt.20.12.2019, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, kundër të pandehurit: E.F, për veprat penale; I. Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së, II. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së, III. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,

Kjo çështje fillimisht është trajtuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, e sipas aktgjykimit të kësaj Gjykate P.nr.693/2019 të datës 11 nëntor 2019, i pandehuri E.F është shpall fajtor dhe është dënuar siç është konstatuar në aktgjykim.

Më 5 shkurt 2020 Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, sipas aktvendimit të saj PA.1.nr. 1588/2019, e ka anuluar aktgjykimit e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri,

P.nr.693/2019 dt.11.11.2019 dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje për shkak të mungesës së kompetencës lëndore nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, lëndën e ka bartur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda.

- Kompetenca;

Gjykata Themelore në Mitrovicë, ka vlerësuar kompetencën lëndore , sipas nenit 1, paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Sipas nenit neni 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra e pretenduar penale ka ndodhur në Vushtrri, dhe rrjedhimisht lënda bie brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 29, paragrafi 1, i KPP-ës. Sipas aktakuzës së prokurorisë veprat për të cilat akuzohet i pandehuri janë veprat penale nga neni 366 par.1 KPRK-së, duke u bazuar në nenin 22 par.1 pika 1.75 të KPP-së, ky rast bie në kompetencë lëndore të Departamentit për Krime të Rënda, andaj e tërë çështja penale është gjykuar pranë kësaj gjykata dhe departamenti.

- Rrjedha e procedurës:

Më 24 qershor 2020, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale. Në këtë seancë i pandehuri e ka mohuar fajësinë lidhur për veprat penale për të cilat akuzohet.

- Shqyrtimi gjyqësor;

Në këtë çështje penale janë mbajtur katër (4) seanca të shqyrtimit gjyqësor, më dt.30.09.2021, 09.11.2021, 17.12.2021 dhe 28.02.2021.

- Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor;

Shqyrtimi gjyqësor ka qenë i mbyllur për publikun, sipas vendimit të KGJK-së dhe vendimit të trupit gjykues, për shkak të pandemisë COVID-19, me qëllim të ruajtjes së shëndetit të palëve dhe publikut, dhe stafit të gjykatës. Palët nuk kanë paraqitur vërejtje në lidhje me këtë.

- Gjuha e përdorur në shqyrtimin gjyqësor;

Seanca e shqyrtimit gjyqësor është mbajtur në gjuhën shqipe.

- Regjistrimi i seancave të shqyrtimit gjyqësor;

Rrjedha e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale është regjistruar në procesverbal. Palët nuk kanë parashtruar asnjë vërejtje në përmbajtjet e procesverbaleve. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, palëve u është dhënë nga një kopje e procesverbalit siç kërkohet me KPP.

Shqyrtimit gjyqësor – rrjedha dhe përmbajtja e seancave nuk janë regjistruar me audio dhe video, pasi që kanë munguar pajisjet e nevojshme për incizime të tilla, por regjistrimi është bërë në procesverbal me shkrim.

- Siguria në seancat e shqyrtimit gjyqësor;

Gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është shënuar asnjë incident për cenimin e sigurisë për palët apo pjesëmarrësit tjerë në procedurë.

- Prezenca e palëve në shqyrtimin gjyqësor;

Në shqyrtimin gjyqësor kanë prezantuar prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë Naim Beka, i pandehuri E.F dhe mbrojtësi i tij, av.Ahmet Tahiri, në disa seanca kanë prezantuar edhe të dëmtuarit.

- Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor;

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të datës 17.12.2021, janë dëgjuar dëshmitarët H.M dhe I.I. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.17.12.2021 janë administruar provat materiale;

- Provat e administruara;

- raporti mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes
- fotoalbumi, skica nga vendi i ngjarjes
- lista e dëshmimeve të renditura nga policia e Kosovës dt.23.11.2019
- vërtetimi mbi sekuestrimin e armës dhe sendeve tjera
- raportet mjekësore në emër të të dëmtuarve dhe të pandehurit të lëshuar nga Qendra Emergjente nga spital “SH.Z”-V.....
- ekspertiza nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, i dt.27.12.2018

- raporti i ekzaminimit psikiatrik për të pandehurin E.F nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës në Prishtinë dt.20.02.2020.

Gjykata në kuptim të nenit 338 par.1 nën par.1.1 të KPP-ës, vetëm i ka lexuar dhe pranuar si provë, deklaratat e dëshmitarëve A.M, N.M, Sh.F dhe B.N të cilat i kanë dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe në Policinë e Kosovës.

Marrja në pyetje e të pandehurit, fjala përfundimtare – përfundimi i shqyrtimit gjyqësor;

Më 21 tetor 2021, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri E.F nuk ka paraqitur mbrojtjen e tij, ka zgjedh që të mbrohet në heshtje.

- Shpallja publike e aktgjykimit;

Më 2 mars 2022, Gjykata e ka shpallur publikisht aktgjykimin.

Aktgjykimi është shpallur në prezencë të pandehurit E.F, në mungesë të Prokurorit të Shtetit në PTH-Mitrovicë, Naim Beka, mbrojtësit të tij, av.Ahmet Tahiri dhe në mungesë të të dëmtuarve.

- Përmbajtja e fjalës përfundimtare të palëve:

Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë Naim Beka, në fjalën përfundimtare ka deklaruar:

Se mbetet pranë aktakuzës, sepse nga administrimi i provave gjatë shqyrtimit gjyqësor, të dëmtuarave, dëshmitarëve pjesërisht nga deklarata e të pandehurit, nga ekspertiza balistike, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve dhe provave tjera, provohet se i pandehuri ka kryer veprat përkatëse penale. I propozon gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe me rastin e shqiptimi të dënimit, gjykata t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si rrethanë lehtësuese të trajtohet fakti se i njëjti ka qenë korrekt gjatë gjithë seancave gjyqësor, se i njëjti veprat penale i ka kryer në shkallë të zvogëluar të përgjegjësisë penale dhe po ashtu është një indikacion pozitiv siç tha sot edhe eksperti se i njëjti gjatë trajtimit nga ana e tij dhe grupit të ekspertëve në mënyrë korrekte e ka përdor terapinë dhe në mënyrë të habitshme ka treguar rezultate të mira çka po ashtu është një sinjal se i njëjtit po përmirësohet. Ndërsa si rrethanë rënduese të trajtoj faktin se veprat e tilla paraqesin rrezik për shoqërinë dhe jetën e njerëzve.

Mbrojtësi i të pandehurit E.F, av.Ahmet Tahiri në fjalën përfundimtare ka deklaruar:

Se e kundërshton akuzën e prokurorisë themelore në Mitrovicë, për faktin se gjatë këtij procesi gjyqësor u vërtetua që kjo akuzë është ngritur për një kohë rekord, duke pasur parasysh edhe faktin se nga praktika e tillë gjyqësor nuk ka ndodhë që një akuzë të ngritet për më pak se një muaj. Me çka nënkuptojmë apo dyshojmë që nuk janë trajtuar të gjitha provat shfajësuese në

kuptim të nenit 48 të Kodit të Procedurës Penale, prova këto siç është; raporti mjekësor nga spital “Sh.Z”-V....., i dt.23.11.2019 me të cilat janë evidente lëndimet e pësuar nga i pandehuri në këtë incidente, raport ky në përputhje të plotë me deklaratat e dëshmitarëve H.M dhe I.I. Sipas mbrojtësit, i pandehuri në asnjë fazë të kësaj procedure nuk i ka mohuar veprimet e tij, edhe pse nga raporti i Institutit të Psikiatrisë Forenzike dhe nga dëshmia e ekspertit psikiatrik sot në proces gjyqësor, i njëjti në ditën kritike ka qenë me aftësi të zvogëluar të përgjegjësisë. Pra, këto veprime i mbrojturi im i ka kryer për të shmangur sulmin i cili i është bërë nga punëtorët e Kompanisë “S.....”, për një arsye krejt banale për mendimin tonë. Pra, veprimet kanë qenë në kuadër të mbrojtje së nevojshme, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtën akuzë përveç gjendjes faktike ta refuzoj edhe mbi bazën e të drejtës materiale sepse konsiderojmë që prokuroria nuk ka zbatuar parimin e apsorbitimit të veprave penale me çka për të njëjta veprimet është ngarkuar në dy vepra penale. Nga koha e incidentit i mbrojturi im nuk ka kryer ndonjë vepër tjetër penale, i njëjti është socializuar siç e tha edhe psikiatri edhe mbi bazën e këtyre çka u tha më lart të refuzohet akuza.

I pandehuri E.F nuk ka paraqitur fjalën përfundimtare, por është pajtuar në tërësi me fjalën përfundimtare të paraqitur nga mbrojtësi i tij.

Sipas kërkesës së kryetarit të trupit gjykues dhe me vendim të Kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, GJA.nr.126/22, dt.22.03.2022, është vazhduar afati për përpilimin me shkrim të aktgjykimit.

- Gjendja e fakteve dhe faktet jo kontestuese;

Nuk ka qenë kontestues fakti se, të dëmtuarin B.N, Sh.F, A.M, dhe N.M, më datën 23.11.2019, kanë qenë duke punuar në Kompaninë “S....” në vend punishten afër restorantit “H.....” në V..... Kompani “S.....” ka qenë duke realizuar projektin për rehabilitimin dhe asfaltimin e rrugës magjistrale V... –P....., por punimet zhvilloheshin afër qytetit të V..... Me qëllim të sigurimit të vend punimeve, punëtorët e kompanisë me një shirit ndarës e kishte rrethuar zonën e punimeve.

Nuk ka qenë kontestues fakti se, i pandehuri E.F më datën 23.11.2019, rreth orës 09:40, ka qenë duke udhëtuar me veturën e tij, të tipit “Passat” ngjyrë e gjelbër me targa ..... në rrugën magjistrale V.....-P..... Gjersa udhëtonte afër qytetit të V....., me automjet e tij e ka këputur shiritin ndarës, rrjedhojën dhe ka hy brenda zonës së punimeve ku kryente punimet kompania



“S.....”. Pas këtij veprimi të të pandehurit, punëtorët e kompanisë, përkatësisht të dëmtuarit Sh.F dhe A.M menjëherë ia kishin tërhequr vërejtjen të pandehurit, lidhur me këputjen e shiritit rrethues, dhe duke i bërë me dije se nuk lejohet hyrja brenda kantierit të ndërtimit. Si rrjedhojë e kësaj situata në mes të pandehurit dhe punëtorëve të kompanisë “S.....”, kishte ndodhur një mosmarrëveshje, pastaj edhe një përleshje fizike.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, faktet e lartcekura nuk janë kontestuar nga palët. Për më tepër, këto rrethana mbi gjendjen e fakteve janë vërtetuar edhe sipas dëshmimeve të dëshmitarëve, raporteve të policisë, pjesërisht edhe nga mbrojtja që ka paraqitur i pandehuri për këtë rast.

Të gjithë dëshmitarët në këtë rast, B.N, Sh.F, A.M dhe N.M, në dëshmitë e tyre që kanë dhënë në polici, kanë pohuar faktin se ditën kur ka ndodhur rasti, kanë qenë duke punuar në kompaninë “S.....”, afër restoranti H..... në Vushtrri, në rrugën magjistrale V.....–P..... Gjithashtu ata kanë theksuar se i pandehuri me automjetin e tij e ka këputur shiritin ndarës dhe sajllën metalike dhe ka hyrë në zonën ku zhvilloheshin punimet nga punëtorët e kompanisë S..... Sipas dëshmimeve të dëshmitarëve të të cekur më lartë, rrjedh se i kanë tërhequr vërejtjen të pandehurit lidhur me veprimet e tij, duke ia bërë të ditur se ka këputur shiritat dhe ka hyrë në zonën e punimeve, gjë e cila sipas rregulloreve të punës është e ndaluar. Sipas dëshmitarëve, ky komunikim me të pandehurin ka quar në një mosmarrëveshje që pastaj ka kulmuar në përleshje fizike dhe përdorim të armës nga i pandehuri. Faktet e lartcekura vërtetohen edhe nga raportet policore që lidhen me këtë rast, që konstatohet se i pandehuri ditën kritike me automjetin e tij, ka këputur shenjat për sigurinë e punimeve dhe me automjetin ka hyrë në zonën e punimeve që zhvilloheshin nga kompani “S.....”. Për më tepër, edhe i pandehuri E.F në mbrojtjen e tij që ka dhënë në polici, ka pranuar se ditën kritike ka kaluar në rrugën ku kryheshin punimet në fjalë, pranon se ka këputur shiritin rrethues, por sipas tij, kjo ka ndodhur pa dashje.

Gjithashtu sipas raportit mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe foto albumit, konstatohet dhe shihet shumë qartë se në vend punishte janë shkëputur shiritat ndarës me të cilat ka qenë e të rrethuar vendi ku kryheshin punimet nga punëtorët e kompanisë “S.....”.

Gjykata ka vërtetuar se pas veprimeve të të pandehurit, shkëputjes dhe dëmtimit të shiritit ndarës në rrugë dhe cenimit të zonës së punimeve, punëtorët e kompanisë S....., A.M dhe Sh.F, menjëherë i janë ofruar të pandehurit dhe ia kanë tërhequr vërejtjen për këtë gjë. I pandehuri në

këtë komunikim ka treguar dhe shprehur nervozizmi duke i fyer punëtorët e kompanisë S....., dhe në një moment ai me dy duart e ka goditur në gjoks të dëmtuarin Sh.F. Pastaj, i dëmtuari A.M, kishte ndërhyrë me qëllim për të ndaluar të pandehurin dhe qetësuar situatën, mirëpo i pandehuri nuk është ndalur por ka filluar të përleshet me të dëmtuarit, pastaj e nxjerr armën e kalibër 6.35 mm dhe me qëllim që t'i frikësoj dhe kërcënojë të dëmtuarit shtënë (gjuan) dy herë me të njëjtën armë, një të shtënë lartë dhe tjetra poshtë, ku njëra nga predhat e godet gomën e kamionit që ka qenë në vendngjarje.

Se ka pas një mosmarrëveshje dhe përleshje ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarve, këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar përmes dëshmimeve të dëshmitarëve A.M dhe Sh.F. Dëshmitari A.M, në dëshminë e tij dhënë në policinë e Kosovës, për këtë rrethanë ka deklaruar; *“pasi i pandehuri ka shkëput shiritin dhe sajllen ai është ndal me automjet, unë edhe Sh..... jemi ofruar te vetura dhe i kemi thënë; nuk ke ba mirë që e ke këput sajllen dhe shiritin ndarës sepse kjo na kushton”, pastaj ai menjëherë ka fillua të na shaj dhe pastaj me dy duart e ka goditur në gjoks Sh..... Unë kam hy në mes me qëllim që ta largoj, po ai ka qenë shumë nervozë dhe nuk u ndal ka vazhदार të na shajë dhe fyej. Gjithashtu edhe dëshmitari Sh.F në dëshminë e tij që ka dhënë në policinë e Kosovës, për këtë rrethanë ka deklaruar *“personi në fjalë (i pandehuri) u nisë me automjet dhe e ka këput sajllen dhe shiritin ndarës, ka vazhduar ashtu për nja 100 metra, sajllja iu ka ngjitur mbrapa në automjet. Unë dhe A..... i tham që e ke këput sajllen dhe ai na u drejtua me fjalët se prapë e këpus, pastaj ai me dy duart më ka goditur në gjoks.**

Ndërsa, sipas raporteve mjekësore për të dëmtuarit dhe të pandehurin, të lëshuar nga Qendra Emergjente, Spital “Sh.Z” V....., rezulton se të dëmtuarit A.M dhe Sh.F, edhe i pandehuri ditën kritike kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Gjithashtu sipas këtyre raporteve, rrjedh se dy palët kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Dëshmitarët H.M dhe I.I, në shqyrtimin gjyqësor kanë theksuar se ditën kritike e kanë pa të pandehurin të gjakosur në fytyrë. Edhe i pandehuri ka thënë se ka pësuar lëndime dhe se ka qenë i gjakosur, sipas tij, lëndimet i janë shkaktuar nga të dëmtuarit.

Gjykata në bazë të raporteve mjekësore të cekuar si më lartë, gjen se të dëmtuarit por edhe i pandehuri kanë kërkuar dhe pranuar trajtim mjekësor, të njëjtit janë ankuar se kanë dhimbje dhe kanë pësuar lëndime nga ky rast. Gjykata rikujton se objekt i akuzës nuk janë pretendimet e dyanshme të palëve për lëndimet eventuale të pësuar dhe përgjegjësit eventual për këto lëndime. Gjykata ka për detyrim për t'i vërtetuar faktet vendimtare që kanë të bëjnë me këtë pikë të

aktakuzës përkatësisht, faktet në raport me veprën penale përdorim i armës në mënyrë kërcënuese, vepër kjo, për të cilin akuzohet i pandehuri. Megjithatë, kjo gjykatë gjen se në këtë rast ka ndodhur një përleshje në mes palëve, gjë që evidentohet edhe në raportet mjekësore. Për sa i përket lëndimeve që janë evidentuar tek i pandehuri, me gjasë të madhe janë shkaktuar nga të dëmtuarit gjatë përprjekjes për të ndaluar sulmin apo përprjekjes për t'ia hequr armën nga dora të pandehurin E.F. Gjykata nuk ka arrit që të vërtetoj se kemi të bëjmë me rrethanat e mbrojtës së nevojshme, pasi që mungon elementi i sulmit në raport me të pandehurin, si një prej kushteve themelore të këtij instituti. Pothuajse të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve tregojnë se i pandehuri i ka sulmuar të dëmtuarit dhe jo e kundërta që të dëmtuarit e kanë sulmuar të pandehurin.

Gjykata për këto rrethana i merr si të besueshme deklaratat e të dëmtuarve (dëshmitarëve), sepse dëshmitë e tyre janë konsistente edhe me deklaratat tjera që kanë dhënë ata për këtë rast, se dëshmitë e dëshmitarëve kanë përputhshmëri të plotë për faktet kryesore. Për më tepër, deklaratimet e tyre janë përputhshmëri edhe në provat tjera, siç janë; raportin mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, foto-dokumentacionin, por edhe me deklaratimet e dëshmitarëve tjerë. Gjykata nuk i fal besimin mbrojtjes së të pandehurit, *“kur pretendon se ka qenë i sulmuar nga të dëmtuarit dhe për të shmangur sulmin ka përdorur armën”*. Sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim i të pandehurit nuk gjen asnjë mbështetje në provat që janë administruar në këtë rast. Të gjithë të dëmtuarit në këtë rast, kanë deklaruar se ditën kritike ka qenë i pandehuri ai i cili ka përdorë fjalë fyese, sharje në raport me punëtorët e kompanisë S....., pastaj edhe fizikisht është përleshur me ta.

Andaj, Gjykata përtej çdo dyshimi e ka vërtetuar se më dt.23.11.2019 në V..... i pandehuri ka përdorur armën pistoletë “Ekol Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ....., ashtu që me të njëjtën armë ka shtënë dy herë më qëllim të kërcënimit dhe frikësimit të dëmtuarve B.N, Sh.F, A.M dhe N.M.

Gjykata vjen në një përfundim të tillë, duke u mbështetur në dëshmitë e dëshmitarëve, B.N, Sh.F, A.M dhe N.M, të cilët kanë pohuar se i pandehuri ditën kritike ka poseduar dhe përdorur armën, ashtu siç theksohet në këtë aktgjykim. Gjykata i merr për të vërteta këto pohime të dëshmitarëve, duke i konsideruar të mbështetshme dhe në përputhen me gjitha provat tjera materiale dhe personale. Përveç dëshmive të dëshmitarëve, edhe provat tjera e dëshmojnë se i pandehuri ka

përdorur armën ditën kritike, siç janë; raporti mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, foto-dokumentacioni, vërtetimi për sekuestrimin e sendeve.

Për më tepër edhe i pandehuri në mbrojtjen e tij, pranon se ka përdoruar armën ditën e ngjarjes, për këtë rrethanë ka deklaruar; *“unë e pata një armë të zjarrit në gjepin e jaknës sime, e nxjerra nga gjepi dhe gjuajta një herë në ajër dhe një herë në tokë, nuk e kam pas qëllimin me lëndua askënd por e kam përdorur për vetëmbrojtje”*. Gjykata e pranon si të vërtetë këtë pjesë të deklaramit nga i pandehuri, përveç pretendimeve se armën e ka përdor për vetëmbrojtje. Duke u bazuar në nenin 123 paragrafi 5 të [KPP], kjo Gjykata i referohet deklaratës që ka dhënë i pandehuri për këtë rast në fazën e mëhershme të procedurës në raport me gjendjen e fakteve.

Të dëmtuarit B.N, Sh.F, A.M, dhe N.M kanë pohuar se ditën kritike e kanë pa të pandehurin duke e nxjerr armën e zjarrit, pastaj me të njëjtën armë ka shtënë disa herë. Gjithashtu edhe dëshmitarët H.M dhe I.I, kanë deklaruar se ditën kritike e kanë pa të pandehurin E.F që mbante një armë të shkurt në dorë. Ndërsa, dëshmitari M....., ka thënë se ka arrit t’ia heq armën nga dora të pandehurit dhe e ka vënë nën kontroll, gjersa ka arrit një patrullë e policisë.

Për më tepër, sipas raportit mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe foto- albumit, vërtetohet fakti se më datën 23.11.2019 në vendin e ngjarjes në rrugën magjistrale V.....-P....., përballë lokalit “M.K” në V....., kanë hasur dhe evidentuar disa dëshmi nga gjuajtja me armë të zjarrit dhe atë: (2) dy gëzhoja, një armë me numër serik ....., (2) dy fishek dhe karikator i armës së njëjtë të sekuestruar nga i pandehuri.

Sipas raportit të ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, vërtetohet se janë ekzaminuar dëshmitë; dy fishek, dy gëzhoja, arma, dhe karikator i zbrazët. Pas ekzaminimit ka rezultuar se armë i përket llojit pistoletë “Eko Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ....., e prodhuar në Turqi. Gëzhojat dhe fishekët janë të kalibrit 6.35mm, ndërsa gëzhojat që janë ekzaminuar janë shkrepur (gjuajt) nga e njëjta armë, pra, arma pistoletë “Eko Tuna”, kalibrit 6.35mm, të cilën armë i pandehuri e mbante pa leje.

Në aktakuzën e prokurorisë, përshkruhen se kanë qenë katër të shtëna me armë nga i pandehuri. Dëshmitari N.M, ka deklaruar se kanë qenë dy të shtëna *“Sa unë dije kanë qenë dy tri të shtëna, por për dy jam i sigurt”*. Dëshmitari Sh.F, ka deklaruar se ka dëgjuar vetëm një krismë të armës, por nuk e di me saktësi drejtimin e të shtënave”. Dëshmitari B.N ka deklaruar se ka dëgjuar tri të shtëna të armës. Ndërsa i pandehuri ka thënë se ka shtënë dy herë me armë; *“unë e pata një*

*armë të zjarrit në gjepin e jaknës sime, e nxjerra nga gjepi dhe gjuajta një herë në ajër dhe një herë në tokë, nuk e kam pas qëllimin me lëndua askënd por e kam përdorur për vetëmbrojtje”.*

Gjykata nxjerr këtë përfundim se i pandehuri ditën kritike e ka përdorur armën e zjarrit dhe me të ka shtëna dy herë, njëra prej të shtënave ka qenë e drejtuar lartë apo në ajër dhe tjetra poshtë në tokë. Gjykata është e bindur se kanë qenë vetëm dy të shtëna, pasi që provat peshojnë më tepër në këtë drejtim. Raporti mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, foto-dokumentacioni, raporti i ekspertizës balistike, mbrojtja e të pandehuri dhe deklarimi i dëshmitarit A.M, që të gjitha këto dëshmi e dëshmojnë këtë. Ndërsa gjykata nuk i pranon dëshmitë e dëshmitarëve të cilët theksoj se kanë qenë me shumë se dy të shtëna me armë. Raporti mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, konstaton se njëra nga predhat e ka goditur gomën e kamionit pronë e kompanisë “S.....”, i cili ka qenë në vendngjarje, ndërsa predha tjetër nuk dihet drejtimi. Andaj, mund të konstatojmë se njëra ka të shtënat me armë ka qenë në drejtim poshtë apo në tokë, ndërsa e shtëna tjetër ka qenë lartë në ajër, siç edhe deklaruar i pandehuri në mbrojtjen e tij.

Sipas raportit mbi ekzaminimin psikiatrik për të pandehurin E.F nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë, i dt.20.02.2020, si dhe mendimit i ekspertit të psikiatrisë Dr.Shpend Haxhibeqiri, gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezulton se i pandehuri ka kryer veprën penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, por jo në shkallën esenciale. Sipas nenit 18 paragrafi 2 [KPRK], personi me aftësi të zvogëluar mendore konsiderohet penalisht përgjegjës. Për më tepër, sipas eksperteve rezulton së shkalla e përgjegjësisë te i pandehuri ishte e ulur por që nuk ka qenë e tillë, *pra në nivelin aftësisë esencialisht të zvogëluar apo paaftësisë mendore*. Andaj, Gjykata vlerëson se nuk plotësohen kushtet ligjor që të pandehurit t’i shqiptohen masat e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri apo me ndalim. Sipas nenit 85 paragrafi 1 dhe nenit 86 paragrafi 1 i KPRK, masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik *mund t’i shqiptohen kryerësit që ka kryer veprën penale në gjendje e paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar*. Për më tepër, prokurori me rastin e dorëzimit të akuzës në gjykatë por dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk ka paraqitur ndonjë propozim për shqiptimin masës së trajtimit të detyruar psikiatrik. Edhe eksperti psikiatrisë Dr.Shpend Haxhibeqiri, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk ka nevojë që të pandehurit t’i shqiptohet ndonjë masë e trajtimit psikiatrik, për shkak se gjendja e tij është përmirësuar tej mase dhe ka kaluar një kohë e gjatë nga ngjarja që ka ndodh.

Gjykata përtej çdo dyshimi gjen se në veprimet e të pandehurit konsumohen të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale; Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 e sanksionuar me Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kjo veprë penale është sanksionuar kështu; Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Lidhur me veprën penale armëmbajtje pa leje;

- Akuza e prokurorisë;

Prokuroria Themelore në Mitrovicë e akuzon të pandehurin E.F se deri më 23.11.2019 ka mbajtur pa leje armën e llojit pistoletë “Eko Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ....., në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm për armë, Ligjin Nr.05/L -022.

Gjykata rikujton se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka qenë kontestues asnjë fakt në raport me veprën penale armëmbajtje pa leje.

Trupi Gjykues si të vërtetuar ka marrë faktin se i pandehuri E.F, gjer më 23.11.2019, pa leje përkatëse ka qenë në posedim dhe në kontroll të armës së llojit, pistoletë “Eko Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ....., e prodhuar në Turqi.

Trupi gjykues, faktet e sipër cekura i ka vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimit shqyrtim gjyqësor. Sipas raportit për këqyrjen e vendit të ngjarjes, konstatohet se më dt.23.11.2019, në vendin e ngjarje policia, nga i pandehuri ka sekuestruar armën pistoletë “Eko Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ..... Sipas foto-albumit pjesë e raportit nga këqyrja e vendit të ngjarjes, shihet qartë arma, gëzhojat dhe karikatorit që janë sekuestruar nga i pandehuri. Sipas vërtetimit për sekuestrimin e sendeve dhe raporteve policore, konstatohet se më 23.11.2019, policia e Kosovës, te i pandehuri kanë sekuestruar sendet si në vijim (një) 1 armë kalibrit 6.35 mm, (1) një karikator, (2) dy fishek dhe (2) dy gëzhoja. Sipas raportit të ekspertimit e lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, vërtetohet se janë ekzaminuar dëshmitë; dy fishek, dy gëzhoja, arma, dhe karikatorit i zbrazët dhe pas ekzaminimit ka rezultuar se arma i përket llojit pistoletë “Eko Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ....., e prodhuar në Turqi, si dhe plumbat janë të të njëjtës armë.

Gjithashtu edhe në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, Sh.F, A.M, dhe N.M, H.M dhe I.I, vërtetohet fakti se i pandehuri ditën kritike ka poseduar një armë të shkurtër të zjarrit, të cilën pastaj e ka sekuestruar policia.

Për më tepër, i pandehuri në mbrojtjen e tij, ka pranuar se për një kohë të gjatë ka mbajtur dhe poseduar armën dhe municionin pa leje të vlefshme.

Gjykata rikujton se vepra penale e armëmbajtjes pa leje, sanksionohet sipas nenit 366 (par.1) të KPRK-së, kështu: “Kushdo që mbanë në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët e tilla, dënohet sipas nenit 366 (1) KPRK-së.

Gjykata konsideron se kontrolli armës përfshinë; ruajtjen apo mundësinë e qasjes së armës dhe posedimin, ndërsa posedimi përfshinë; posedimin personal të armës, pushtetin faktik mbi atë pa marrë parasysh pronësinë e armës e njësoj sikur të kesh armën.

Për më tepër, pistoletë “Ekol Tuna”, kalibrit 6.35mm, sipas Ligjit për armët (Ligjit Nr.05/L - 022), neni 2 par.1 pika 1.9 përkufizohet *“armë e shkurtër e zjarrit” që nënkupton; Armën e zjarrit me tytë, e cila nuk e kalon gjatësinë prej 30cm apo gjatësia e gjithmbarshme e së cilës nuk kalon 60cm”*.

Përveç kësaj, arma-pistoleta dhe municioni mund të mbahen në posedim, pronësi apo kontroll vetëm me leje përkatëse të lëshuar nga organi kompetent, sipas kushteve, kriterëve dhe procedurave për pajisjen me leje përkatëse që rregullohen sipas Ligjit për armët (Nr.05/L -022).

Për më tepër, “Armëmbajtje - të gjitha mënyrat e bartjes së armës, përmes të cilave arma e zjarrit është e gatshme për përdorim të menjëhershëm; Neni (2 (1.49) i Ligjit për armët. Në këtë përkufizim nënkuptohet edhe posedimin faktik të armës, sepse pronar juridik cilësohet poseduesi që mban armën në bazë të lejes përkatëse, leja për bartje përveç saj e identifikon edhe pronarin e armës në të njëjtin përshkrim dhe kuptim hynë edhe posedimi i fishekëve.

Gjykata si përfundim gjen se i pandehuri në kundërshtim me nenit 4 (1.2) dhe 4 (1.2.1), të Ligjit për armët (Nr. 05/L -022), nga koha e papërcaktuar e gjer më dt.23.11.2019, pa leje të vlefshme ka mbajtur dhe poseduar armën e zjarrit të llojit pistoletë “Ekol Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ....., dhe municionin për këtë armë.

- Forma e përgjegjësive penale me këtë veprë penale.

Vetëm dashja mjafton për kryerjen e kësaj veprë penale, pasi që pakujdesia përjashtohet shprehimisht sipas nenit 366 të KPRK-së dhe siç kërkohet me nenin 17 paragrafi 2 të KPRK-së. Gjykata gjen se i pandehuri ka qenë në dijeni për posedimin e armës si dhe për mungesën e lejes përkatës, përkundër kësaj ka vazhduar të mbajë armën e tillë deri më 23.11.2019 kur edhe është sekuestruar kjo armë nga policia.

Gjykata i pranon si të vërteta dhe të ligjshme provat materiale dhe dëshmitë e dëshmitarëve që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Sa i përket vlerës provuese, provat materiale dhe dëshmitë e dëshmitarëve, provojnë faktet esenciale në raport me ekzistimin e veprës penale dhe tregojnë qartë kryesin e saj. Për gjykatën, këto prova janë të pranueshme dhe të besueshme sepse janë siguruar në rrugë të ligjshme nga organet kompetente sipas ligjit. Ndër të tjera, provat e administruara në shqyrtim gjyqësor që kanë të bëjnë me këtë pikë të akuzës nuk janë kundërshtuar nga palët.

Andaj, Gjykata përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri E.F ka kryer veprën penale; Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, mbi këtë bazë gjykata e ka shpall fajtor dhe e ka dënuar sipas ligjit.

- Lidhur me konfiskimin e armës;

Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2 të KPP-ës dhe nenit 366 par.3 KPRK-ës, ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm dhe të përhershëm të armës, municionit dhe karikatorit të armës së njëjtë ndaj të pandehurit E.F.

Gjykata rithekson se i pandehuri nuk posedonte leje të vlefshme e as autorizim për posedimin apo mbajtjen e armës në fjalë. Në anën tjetër, sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyra automatike, andaj, për këto arsye ka vendosur t'i konfiskoj përherë dhe ka urdhëruar që këto sende të shkatërrohen. Gjykata vlerëson se plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armës dhe municionit sipas nenit 366 par.3 KPRK-ës, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, dhe konfiskimi i tyre është propozuar në aktakuzë. Për më tepër, dispozita e lartcekur e këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të sendeve (armës) së tillë.



- Lidhur me pikën I, të aktakuzës dhe aktgjykimit (pjesën liruese);

Prokuroria pretendon se i pandehuri më datën 23.11.2019, rreth orës 09:40, në rrugën magjistrale V.....-P....., përballë lokalit “M.K” në V..... ka shtënë disa herë me armë tij të zjarrit, pistoletën e kalibër 6.35mm, kësisoj dhe ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve, përkatësisht për të dëmtuarit H.M, B.N I.I, Sh.F, A.M, dhe N.M.

I pandehuri e ka mohuar fajësinë për këtë veprë penale. Gjithashtu, mbrojtësi i të pandehurit e ka kundërshtuar akuzën në raport me këtë veprë penale.

- Faktet jokontestuese;

Nuk ka qenë kontestuese fakti se i pandehuri se më dt.23.11.2019 ka përdorur armën, pistoletë “Ekol Tuna”, kalibrit 6.35mm, me numër serik: ....., siç edhe ka vërtetuar gjykata në këtë aktgjykim (në faqe 11).

Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ditën kritike pas mosmarrëveshjes me të dëmtuarit B.N, Sh.F, A.M dhe N.M nga rrobat e tij ka nxjerr armën pistoletën “Ekol Tuna”, dhe ka shtënë dy herë me të njëjtën armë. Gjykata ka vërtetuar faktin se kanë qenë vetëm dy të shtëna me armë nga i pandehuri dhe jo katër të shtëna, siç pretendon prokuroria. Gjykata ri përsërit se të shtënat me armë kanë qenë, njëra poshtë në tokë dhe tjetra lart apo në ajër. Gjykata në raport me të gjitha këto rrethana, ka dhënë sqarime dhe arsyetim të plotë në këtë aktgjykim [faqe 11 dhe 12].

- Faktet kontestuese;

Si fakt kontestues ka qenë nëse në veprimet e të pandehurit përmbushen elementet e posaçme të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm sipas nenit 356 të KPRK-së.

Gjykata duke u bazuar në provat që janë pjesë e lëndës, gjen se në veprimet e të pandehurit nuk përmbushen elementet e veçanta të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm. Gjykata në këtë përfundim arrin duke u bazuar në provat si në vijim; raportin dhe skicën mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, foto- albumin, raporti i ekspertizës nga AKF, dëshmitë e dëshmitarëve si dhe nga mbrojtja që ka paraqitur i pandehuri.

Gjykata rikujton se vepra penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm është e sanksionuar sipas nenit 356 paragrafi 1 [KPRK]. Nga përkufizimit ligjor i kësaj veprë penale, kërkohen që të

plotësohen së paku dy kushte themelore, ashtu që; *që përmes mjeteve, pajisjeve, sendeve apo veprimtarive të rrezikshme të shkaktohet;*

- *rreziku i madh për jetën e njerëzve apo*
- *dëmi i konsiderueshëm material*

Gjykata duke analizuar këtë dispozitë ligjore dhe gjendjen e fakteve, vlerëson se në veprimet e të pandehurit nuk janë konsumuar elemente të veçanta të kësaj vepre penale, sepse përkundër që i pandehuri ka shtënë me armë, nuk shkaktuar rrezik i madh për jetën e njerëzve apo dëmi i konsiderueshëm material, për shkak të disa rrethanave që do t'i paraqesim në vijim.

Së pari, i pandehuri ditën kritike ka përdorur armën e shkurtër të zjarrit, pistolen “Ekol Tuna” e kalibrit 6.35 mm, me të cilën armë ka shtënë vetëm dy herë dhe të shtënat kanë qenë, njëra me trajektore (drejtim) poshtë apo në tokë dhe tjetra lart apo në ajër.

Së dyti, këto dy të shtëna me armë kanë qenë në ambient të hapur në rrugën magjistrale V.....- P....., përballë lokalit “M.K” në V..... Përkundër faktit se vendi ngjarjes ka qenë një vend publik, mirëpo në kohën e ngjarjes nuk ka pas qarkullim të qytetarëve në atë zonë, për shkak të punimeve që po kryheshin në atë pjesë rrugë dhe lëvizjet e personave të paautorizuar ka qenë e kufizuar me shirita të tejdukshëm.

Së treti, në momentin e të shtënave me armë nga i pandehuri, vetëm dy të dëmtuarit, A.M dhe Sh.F, kanë qenë në një distancë të afërt me të, ndërsa të dëmtuarit tjerë kanë qenë shumë me larg nga vendi i të shtënave. Siç rezulton nga provat, në momentet kur është zhvilluar ngjarja (të shtënat me armë), përveç të dëmtuarve, aty afër apo përreth nuk ka pas persona tjerë.

Duke u bazuar në gjendjen e fakteve, vendit ku i pandehuri e ka përdor armën, lloji armës [një armë e shkurt e zjarrit kalibrit vogël], numrin e të shtënave si dhe trajektoren apo drejtimin tyre, mbi këto rrethana mund të konstatojmë se me përdorimin e armës nga i pandehuri në këtë rast nuk është vërtetuar se ka shkaktuar rrezik i madh apo real për jetën e njerëzve e as nuk është shkaktuar dëmi i konsiderueshëm material.

Gjykata sqaron se në secilin rast përdorimi i pakontrolluar i armës\ve, përveç vendeve të posaçme për gjuajtje, vetvetiu krijon një gjendje të rreziku abstrakt, sepse arma për nga karakteristika e

saj paraqet një send të rrezikshme. Megjithatë të vepra penale e shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, kërkohet që rreziku të jetë i madh dhe real për jetën e njerëzve, që nuk mjafton të shkaktohet vetëm një rrezik i supozuar apo apstrakt. Për t'u konsumuar kjo vepër penale, është e nevojshme që të shkaktohet një rrezik konkret për objektin e mbrojtur jetën, trupin a pasurinë, gjë që nënkupton krijimin e një gjendjeje të tillë në të cilën, sipas përvojës së përgjithshme, bëhet reale mundësia që në çdo çast të shkaktohet pasoja për objektin e mbrojtur, por një gjendje e tillë në rastin konkret nuk ka ekzistuar.

Nga karakteri i përgjithshëm i kësaj vepre penale rezulton edhe karakteri i saj subsidiar, ngase ajo do të ekzistojë vetëm po që se në një rast konkret nuk janë realizuar elementet ligjore të ndonjë vepre tjetër penale të këtij kapitulli.

Në këtë rast, prokuroria për të njëjtat veprime përkatësisht, për përdorimin e armës e sipas akuzës e akuzon të pandehurin për dy vepra penale; Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm sipas nenit 356 par.1 [KPRK] dhe veprën penale; Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 367 par.1 [KPRK].

Mirëpo kjo Gjykata vlerëson se përdorimi i armës nga i pandehurit siç është përshkruar në akuzë dhe në këtë aktgjykim, konsumon vetëm elementet e veçanta të një vepre penale dhe atë; Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 [KPRK], e si rrjedhojë kjo Gjykata e ka shpall fajtor dhe dënuar të pandehurin për këtë vepër penale.

Për më shumë, konsiderojmë se në veprimet e të pandehurit nuk janë konsumuar elementet e dy veprave penale, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, por vetëm elementet e veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, sepse për këtë plotësohen elementet e posaçme dhe qëllimi, ngase i pandehuri armën e ka përdorur me qëllim që t'i frikësoj dhe kërcënoj të dëmtuarit.

Gjykata rikujton se sipas neni 7 paragrafin 2 të KPP-së, që përcakton se prokuroria e shtetit obligohet që me përkujdesje dhe përkushtim t'i vërtetojë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favorin e tij.

Aktakuza në pikën I, sipas vlerësimit të kësaj Gjykata nuk i plotëson kushtet dhe kërkesat ligjore siç kërkohen me nenin 241 të KPP-ës, sepse nuk jepen arsye për elementet bazë të veprës penale,

për të cilën akuzohet i pandehuri. Aktakuza nuk jep shpjegime mbi faktet kryesore, arsyet për të bindur një vëzhgues objektiv se i pandehuri ka kryer veprën penale. Akuza mbështetet në prova të cilat në mënyrë të qartë e dëshmojnë të kundërtën e tezës së akuzës, pra provojnë se i pandehuri nuk ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet sipas pikës I të aktakuzës.

Gjykata konstaton se nuk ka bazë që i pandehuri të shpallet fajtor për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Andaj, vendosi që të pandehurit ta liroj nga akuza për këtë veprë penale, pasi që nuk është vërtetuar se në veprimet e tij përmbushen elementet e kësaj vepre penale.

- Aspekti ligjore dhe obligimet e prokurorisë;

Gjykata, rikujton se sipas nenit 48 të KPP-ës, prokurori i shtetit ka për obligim që gjatë hetimit të veprave penale të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të siguroj që një hetim të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit dhe që mbledhja e provave të mos bëhet në kundërshtim me Kapitullin XVI të këtij kodi. Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 242 të KPP-ës, përcaktohet se në akuzë duhet të jepen shpjegimet e arsyeshme për ngritjen e akuzës bazuar në rezultatin e hetimeve dhe provave që i vërtetojnë faktet kryesore, ndërsa në rastin konkret prokuroria, nuk ka siguruar prova që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte që do të mund të vërtetonte se në veprimet e të pandehurit përmbushen elementet e veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm.

- Llogaritja e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar:

Gjykata duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së, që përcakton se masa e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak, duhet të llogaritet në dënimin e shqiptuar, mbi këtë bazë Gjykata i ka llogaritur të pandehurit E.F kohën e kaluar në paraburgim nga dt.23.11.2019 e deri më datën 03.04.2020 si dhe kohën e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga dt.03.04.2020 e deri më datën 03.05.2020, në dënimin e shqiptuar.

- Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin E.F, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar, dashjen direkte të shfaqur te këto vepra penale, shkallën e përgjegjësisë penale, kontributin esencial të tij te këto vepra penale, faktin se për një kohë të gjatë ka mbajtur armën

pa leje, pastaj të njëjtën armë edhe e ka përdorur ashtu siç përshkruhet në këtë aktgjykim, si dhe rrezikshmërinë e veprës penale.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese është vlerësuar sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale, faktin se me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, ka pranuar fajësinë për veprën penale armëmbajtje pa leje edhe pse gjykata nuk e ka aprovuar pranimin e fajësisë për shkaqet që janë theksuar në këtë aktgjykim, faktin se i pandehuri është familjar, mbajtës i familjes, shkallen e përgjegjësisë që është konstatuar se ka vepruar në shkallen e përgjegjësisë së zvogëluar. Gjykata vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të pandehurit, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e të pandehurit dhe rrethanat e tjera që i kemi cekur më lartë është adekuat dhe jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat e tjerë, që në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të pandehurin gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marr parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

- Shpenzimet e procedurës:

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-ës.

- Lidhur me kërkesën pasurore juridike:

Pala e dëmtuara për realizimin kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Gjykata nga arsyet e cekura si më lartë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykim

#### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.10/2020 të dt.16.05.2022

Procesmbajtësi:

Endrit Hajrizaj

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit me shkrim të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, ankesa duhet të jetë me shkrim dhe të dorëzohet në administratën e kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.